



UNIVERSITETI "HAXHI ZEKA" PEJË

RAPORT

MONITORIMI I IMPLEMENTIMIT TË STRATEGJISË PËR PERIUdhËN JANAR 2019 – DHJETOR 2019

Mars 2020

Përmbledhje

Universiteti "Haxhi Zeka" gjatë vitit 2019 ka vendosur që të zhvillojë Strategjinë e re pesëvjeçare (2020-2024). Strategjia e re është hartuar, aprovuar ka filluar së zbatuari që nga fillimi i vitit 2020.

Përkundër aktiviteteve rreth hartimit të dokumentit të ri strategjik, UHZ kishte vazhduar me implementimin e aktiviteteve për vitin 2019, të planifikuara në dokumentin e kaluar strategjik (2017-2022)

Ky raport i përmban të dhënat dhe rezultatet nga monitorimi i zbatimit të strategjisë së kaluar të UHZ-së, dhe përfshinë periudhën kohore Janar – Dhjetor 2019

Monitorimi i zbatimit të planit strategjik është bërë nga Komisioni për Monitorimin e Zbatimit të Strategjisë në mënyrë periodike përgjatë gjithë vitit 2019 dhe përfshinë monitorimin e të katër objektivat strategjike të strategjisë së kaluar:

1. Avancimi i vazhdueshëm i mësimdhënies dhe i të mësuarit
2. Avancimi i hulumtimeve dhe orientimi drejt inovacionit
3. Bashkëpunimi ndërkombëtar dhe ndërinstitucional
4. Menaxhimi dhe zhvillimi i qëndrueshëm i burimeve

Në planin strategjik për vitin 2019 ishin të planifikuara gjithsejtë 49 aktivitete të shpërndarë në katër sektorët strategjik. Nga dyzet e nëntë zëra në planin strategjik për vitin 2019, është vërejtur progres në tridhjetë e pesë prej tyre ndërsa në katërbëdhjetë prej tyre nuk ka pasur progres të mjaftueshëm. Një progres solid është vërejtur në përmbushjen e aktiviteteve të planifikuara në fushën e avancimit në mësimdhënie dhe të mësuarit duke shfrytëzuar trajnimet për mësimdhënie, kurset dhe ligjëratat nga personeli vendor dhe ndërkombëtar. Ngecje është vërejtur në përmbushjen e aktiviteteve të planifikuara në sektorin e hulumtimeve siç është mos-përmbushja e disa aktiviteteve të planifikuara për hapjen e instituteve hulumtuese si dhe realizimi jo i mjaftueshëm i projekteve hulumtuese dhe i organizimit të konferencave më karakter ndërkombëtar.

UHZ-së ka vazhduar të jetë pjesë e projekteve të ndryshme në vend si dhe jashtë vendit edhe gjatë vitit 2019. Pjesëmarrja në projekte të ndryshme ka ndihmuar në vazhdimin e konsolidimit të lidhjeve dhe bashkëpunimit të qëndrueshëm me institucione të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare. Progres gjatë vitit 2019 është vërejtur edhe sa i përket ngritjes së cilësisë në menaxhim. Monitorimi i implementimit të strategjisë për vitin 2019 ka gjetur se UHZ ka arritur të avancojë në aspektin e përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies, por duket se mbetet akoma sfiduese çështja që ka të bëjë me hulumtime shkencore dhe organizimin e konferencave shkencore me karakter vendor dhe ndërkombëtar.

Megjithatë, mund të thuhet se monitorimi i zbatimit të planit strategjik për vitin 2019 ka treguar se në pjesën e dytë të vitit paraprak kishte një mobilizim të përgjithshëm të UHZ-së për hartimin e planit strategjik të ri, përmes të cilit pritët që të adresohen të gjitha sfidat por edhe të shfrytëzohen përparësitë dhe mundësitë e zhvillimit të suksesshëm të këtij Institucioni publik.

Hyrje

Universiteti “Haxhi Zeka në Pejë deri në fund të vitit 2019 ka zbatuar Strategjinë zhvillimore për periudhën 2017-2022 e cila ishte aprovuar në maj të vitit 2017 me objektiva strategjike për avancim të mësimdhënies, hulumtimit dhe inovacionit, zhvillimit të qëndrueshëm të burimeve njerëzore, financiare dhe infrastrukturore si dhe angazhimin e vazhdueshëm në bashkëpunim ndërkombëtar dhe ndërinstitucional.

Ky raport përfshinë rezultatet nga monitorimi i zbatimit të strategjisë përgjatë vitit 2019 të cilat kanë të bëjnë me:

- Vlerësimet rreth përmbushjes së objektivave nga fillimi deri në fund të vitit 2019
- Përcaktimin e prioriteteve për vitin e ardhshëm

Procesi i rishikimit të zbatimit të strategjisë për vitin 2 ka përfshirë:

- Takimet me Komisionin e emëruar për monitorimin e zbatimit të strategjisë së Universitetit “Haxhi Zeka”
- Grumbullimin e të dhënave nga të gjitha njësitë akademike dhe organet drejtuese të Universitetit rreth zbatimit të aktiviteteve nga plani strategjik për vitin 2019
- Krahasimi i të dhënave të grumbulluara me aktivitetet e planifikuara për vitin 2019

Konteksti

Në planin strategjik për vitin 2019 ishin përcaktuar aktivitetet sipas objektivave strategjike përmes të cilave UHZ do të realizonte më së miri misionin e tij.

Në verën e vitit 2019, UHZ kishte dështuar që të akreditohej në nivel institucional, përkundër akreditimit të shumicës së programeve studimore. Përkundër mobilizimit për hartimin e një plani të ri strategjik, UHZ kishte vendosur që në ndërkohë të vazhdohej me implementimin e aktiviteteve nga plani i kaluar strategjik për vitin 2019, derisa të aprovohej Plani i ri Strategjik. Ky raport merr në konsideratë aspektet që kanë të bëjnë me monitorimin e zbatimit të aktiviteteve gjatë vitit 2019.

Të arriturat e deritanishme

Plani strategjik i UHZ për vitin 2019 i numëron katër objektiva strategjike në kuadër të së cilave janë shumë nën-objektiva të tjera. Objektivat bazë për vitin 2019 ishin po ato objektivat, të cilat i përmbante strategjia pesë vjeçare e UHZ-së e që ishin:

1. Avancimi i vazhdueshëm në Mësimdhënie dhe të mësuar
2. Avancimi i hulumtimit dhe orientimit drejt inovacionit
3. Angazhimi i vazhdueshëm në bashkëpunimin ndërkombëtar dhe ndërinstitucional

4. Menaxhimi dhe zhvillimi i qëndrueshëm i burimeve

Në kuadër të objektivave dhe nën objektivave strategjike, plani strategjik për numëronte rreth 49 aktivitete/projekte për tu realizuar përgjatë vitit 2019. Të dhënat nga monitorimi tregojnë se është arritur progres në 35 nga 49 aktivitetet e planifikuara. Përditësimet e detajuara për progresin sipas objektivave janë paraqitur në shtojcat e këtij raporti (Shtojca 1 dhe Shtojca 2)

Aktivitetet kryesore të ndërmarra sipas planit për vitin 2019 përfshijnë:

- **Avancimi i vazhdueshëm në mësimdhënie dhe të mësuar**

- Studentët dhe personeli akademik kanë ndjekur master kurse nga personeli ndërkombëtar, ligjërata, dhe internshipe në fushat siç janë: pedagogjia ligjore, qasja në drejtësi, sundimi i ligjit dhe pavarësia e gjyqësorit, mjedisi, turizmi, industria e sigurimeve, aktivitetet agro-biznesore, sistemi tatimor, makro dhe mikrofinancat etj.
- Trajnime rreth mësimdhënies online (e-learning)
- Metodologjitë moderne për hulumtime shkencore
- Ri-dizajnimi i programeve ekzistuese në nivelin bachelor
- Dizajnimi i programeve të reja në nivel bachelor, master dhe doktoraturë
- Vazhdimi me implementimin e programeve të përbashkëta me Universitetet e tjera (Universitetin e Prizrenit dhe të Gjilanit)
- Ndarja e çmimeve për profesorët dhe studentët e dalluar
- Promovimi i më të dalluarve nga personeli akademik, administrata dhe studentët
- Realizimi I projektit të tutorimit
- Pjesëmarrja e studentëve në gara ndërkombëtare

- **Avancimi i hulumtimit dhe orientimit drejt inovacionit**

- Personeli akademik ka vazhduar me prezantimin e punimeve të tyre shkencore në konferenca kombëtare, regjionale dhe ndërkombëtare
- Trajnimi i personelit për avancim në mësimdhënie dhe në hulumtime është në fazat fillestare
- Pjesërisht janë mbajtur kurse të gjuhës angleze për studentë dhe për përfaqësuesit e administratës
- Ka vazhduar tradita në zhvillimin e procedurave rreth përzgjedhjes së punimeve më të mira shkencore të botuara në revista me impakt gjatë vitit 2019 (procedurat e konkursit kanë përfunduar ndërsa përzgjedhja pritet të bëhet shumë shpejt)

- **Angazhimi i vazhdueshëm në bashkëpunimin ndërkombëtar dhe ndërinstytucional**

- Edhe gjatë vitit 2019 ka vazhduar implementimi i projekteve ndërkombëtare ku marrin pjesë fakultetet e UHZ-së siç janë: BUGI, STEPS, CTCIE, QUADIC, ENEMLOS, NAWA. Ekspertët a angazhuar në projektet e lartpërmendur kanë përfunduar të gjitha obligimet për mbarëvajtjen e tyre.
 - Kanë vazhduar edhe gjatë vitit 2019 projektet për shfaqjen e vlerave muzikore përmes koncerteve dhe festivaleve brenda dhe jashtë vendit
 - Stafi akademik është trajnuar se si të aplikojë në projekte dhe grande ndërkombëtare
 - Janë organizuar sesione këshilluese dhe informuese për studentët rreth aplikimit në fonde ndërkombëtare si ERASMUS+ etj.)
 - Ka vazhduar mobiliteti i personelit akademik dhe studentëve. Gjatë vitit 2019, janë 13 persona nga personeli akademik, të cilët kanë qëndruar në vendet e ndryshme siç janë: Polonia, Malta, Shqipëria, Amerika dhe Gjermania
 - UHZ ka vazhduar me arritjen e marrëveshjeve të reja të bashkëpunimit. Gjatë vitit 2019 janë arritur pesë marrëveshje me universitete ndërkombëtare
- **Menaxhimi dhe zhvillimi i qëndrueshëm i burimeve**
 - Përditësimi i strategjisë për sigurimin e cilësisë
 - Ka vazhduar ndërtimi i fakultetit të arteve edhe përgjatë vitit 2019.
 - Është krijuar baza së të dhënave në UHZ
 - Është në zhvillim projekti për qasje në bibliotekat ndërkombëtare

Mjedisi i jashtëm

Gjatë vitit 2019, shumica e programeve studimore në nivelin bachelor dhe master të UHZ-së janë akredituar nga Këshilli Shtetëror i Cilësisë.

Gjatë vitit 2019, UHZ ka dështuar që të akreditohet në nivelin institucional. Mos akreditimi ka bërë që të mobilizohet i gjithë institucioni në përmbushjen e standardeve për institucionet e arsimit të lartë që ndërlidhen me mësimdhënien, hulumtimin, sigurimin e cilësisë bashkëpunimin ndër institucional dhe ndërkombëtar etj. UHZ është përgatitur maksimalisht për tu akredituar në nivelin institucional por edhe për akreditimin dhe ri-akreditimin e programeve studimore të cilat janë në funksion të edukimit dhe punësimit të rinjve. Financimi për arsimin e lartë në Kosovë ka shënuar rritje, kështu që edhe buxheti i UHZ-së ishte më i lartë gjatë vitit 2019.

UHZ, ashtu si edhe institucionet e tjera publike të arsimit të lartë ka vazhduar që edhe gjatë vitit të kaluar të varet nga buxheti i shtetit.

Kapacitetet e stafit akademik por edhe të administratës në institucionet publike mbeten të kufizuara ndërsa sfidë në vete mbeten investimet në infrastrukturë siç janë p.sh. laboratorët, hapësirat për personelin akademik, mensat, kampet sportive etj.

Lëvizja e lirë brenda kufijve të Evropës mbetet akoma e pa realizuar duke kufizuar mundësitë e punësimit jashtë vendit të rinjve kosovarë por edhe të studentëve që përfundojnë studimet në UHZ. Megjithatë, ka shpresë që në të ardhmen të krijohet mundësia e lëvizjes së lirë, prandaj, është me rëndësi që sistemi i arsimit në Kosovë duke përfshirë edhe UHZ-në, t'i përshtatet kërkesave të tregut evropian të punës përmes ngritjes së cilësisë së studimeve.

Si përfundim mund të thuhet se mjedisi i jashtëm edhe gjatë vitit 2019, ka vazhduar të ofrojë disa mundësi siç është rritja e lehtë e buxhetit, por në anën tjetër rritja e papunësisë në vend, pamundësia e lëvizjes së lirë si dhe ulja demografike, mund të reflektojnë në të ardhmen edhe në uljen e interesimit të rinjve për të ndjekur studimet e larta.

Prioritetet afatshkurtra

UHZ së fundmi ka zhvilluar dhe aprovuar Strategjinë pesë vjeçare me objektiva të qarta dhe shumë të rëndësishme për perspektiven e Institucionit. Prioriteti kryesor i UHZ-së mbetet akreditimi në nivel institucional por edhe zbatimi i objektivave të strategjisë.

Të dhënat e grumbulluara rreth realizimit të aktiviteteve gjatë vitit 2019 tregojnë se fokusi i përpjekjeve në afatin e shkurtër do të vazhdojë që të jetë në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies përkundër disa arritjeve në këtë aspekt, ndërsa prioriteti tjetër do të jetë puna hulumtuese shkencore e studentëve dhe e personelit akademik në projekte të ndryshme hulumtuese shkencore në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

Prioritetet afatgjata

UHZ është duke vazhduar me kompletimin e infrastrukturës në mënyrë që kampusi universitar të veprojë me tërë kapacitetin e tij. Te gjeturat nga monitorimi i zbatimit të planit strategjik tregojnë se UHZ është duke vazhduar që të konsolidojë programet dhe profilet aktuale studimore, por do të planifikojë edhe zhvillimin e programeve dhe shërbimeve të tjera që janë të përshtatshme për Pejën, Regjionin dhe për vendin në përgjithësi.

Përfundimet

Si përfundim nga monitorimi i zbatimit të planit strategjik për vitin 2019, mund të thuhet se UHZ ka avancuar në disa fusha strategjike siç është administrimi i institucionit, mësimdhënia dhe pjesërisht bashkëpunimi ndërkombëtar, por gjithashtu është vërejtur se ka ngecje në disa aspekte sidomos në fushën e hulumtimeve shkencore dhe në organizimin e konferencave

shkencore. Gjatë procesit të monitorimit është vërejtur një mobilizim i përgjithshëm i institucionit dhe të gjitha njësive akademike, sidomos gjatë pjesës së dytë të vitit 2019 e që ka rezultuar me hartimin e një dokumenti strategjik pesë vjeçar i cili do të shërbejë si udhërrëfyes për zhvillimin e suksesshëm në të ardhmen.

Prof. Ass. Dr. Agim Rysha

Kryetar i Komisionit për Monitorimin e Zbatimit të Strategjisë

Objektivat kryesore	Numri I aktiviteteve në planin strategjik për vitin 2018	Numri I aktiviteteve ku është arritur progres
Avancimi i vazhdueshëm në Mësimdhënie dhe të mësuar	19	14
Avancimi i hulumtimit dhe orientimit drejt inovacionit	14	7
Angazhimi i vazhdueshëm në bashkëpunimin ndërkombëtar dhe ndërinstytucional	9	8
Menaxhimi dhe zhvillimi i qëndrueshëm i burimeve	7	6
Total	49	35

Shtojca 2: Plani strategjik për vitin 2019

STRATEGJIA E UNZ 2017-2022									
PLANI STRATEGJIK PËR VITIN 2019									
Gjendja më 31 dhjetor 2019									
OBJEKTIVI STRATEGJIK I: Avancimi i vazhdueshëm i mësimdhënies dhe i të mësuarit									
Nën-objektivat	<ul style="list-style-type: none"> Rritja graduale e numrit të studentëve; Rritja e numrit të profesorëve të kualifikuar në marrëdhënie të rregullt të punës; Zgjerimi i njësive akademike dhe përmirësimi i programeve në pajtueshmëri me kërkesat e tregut të punës; Hapja e programeve të doktoratës; Rritja e efikasitetit në studime dhe e mobiliteteve; Zhvillimi dhe avancimi i Zyrës për Zhvillim Akademik dhe i Zyrës së Karrierës; 								
PROJEKTET / AKTIVITET	Aktivitetet/ Hapat	Koha/ muaji	Palët përgjegjëse	Kostoja (Euro)	Financuesit	Bartësit	Mbikëqyrës	Indikatorët matës	Vërejtje
Kurse Master nga stafi ndërkombëtar	Vazhdimi i mbajtjes së 2 Master klasave – njëri në dirigjim, vështirësi orkestrale dhe tjetri në flautë	05/2019	FA	500	UNZ	Profesorë dhe Interpretuesit	Dekanati i FA	2 master kurse të realizuara 10 profesor 50 studentë	Akoma nuk janë mbajtur

Rritja e efikasitetit në studime përmes aktiviteteve jashtë kurikullore dhe mobilitetit	Organizimi i shkollës verore "ESMA" në flautë, saksofon, klarinetë/OB O	08/2019	FA	5000	UHZ/Donator et				I përfunduar 3 profesorë ndërkombëtar dhe 20 studentë të tjerë pjesëmarrës
	Vazhdimi i Organizimit të një Seminarit rreth produkteve të reja bujqësore	06/2019	FAB/FMTHM/Rektorati/Partneret	500	UHZ/Donator et	Dekanati	Rektorati	Pjesëmarrja e prodhuesve vendor dhe rreth 50 pjesëmarrës nga FAB dhe FMTHM	Është majtë Pjesëmarrja 20 studentë të FAB
	I ligjërata në fushën e pedagogjisë ligjore	03/2019	FJ/Rektorati	3500	Donatorët (USAIDI)	Profesor ndërkombëtar Përfaqësues nga Universiteti i OHIO-s	Dekanati	Ligjërata e realizuar 40 studentë dhe 6 mësime të mësimdhënës	Ligjërata e realizuar 40 studentë dhe 6 mësime të mësimdhënës
	Ligjërata në fushën e Drejtësisë "Qasja në drejtësi"	04/2019	FJ	500	Donatorët (Departamenti i Shtetit Amerikan/IN L)	Ligjëruesi nga GLPS	Dekanati	Ligjërata e realizuar 35 studentë dhe 2 mësime të mësimdhënës Zyrtarja QZHK	E realizuar
	Forumi "Gratë e suksesshme frymëzim për të rinj"	03/2019	FJ	2000	Donatorët (OSBE)	Prezantime nga gratë aktive në jetën publike	Dekanati	Rreth 200 pjesëmarrës (studentë, staf akademik, personel administrative, menaxherë)	E realizuar
	Forum "Sundimi i ligjit dhe pavarësia e gjyqësorit"	05/2019	FJ	500	Donatorët (OJQ "Çohu" dhe "KDI")	Prezantime nga OJQ-të, dhe nga Gjyqësori	Dekanati	Rreth 50 pjesëmarrës	Është realizuar me 11.11.2019 "Parashkrimi i lëndëve dhe shkeljet e afateve ligjore në trajtimin e lëndëve penale, si mohim i qasjes në drejtësi",

Forum "Liria e fesë dhe shteti sekular"	10/2019	FJ	200	Universiteti	Prezantimet nga përfaqësuesit e institucioneve fetare, shtetërore, shoqëria civile, komuniteti akademik	Dekanati	Rreth 60 pjesëmarrës	Jo
Ligjëratë nga projekti "Bashkimi I të rinjve rural përtej kufijve" Tema: Punëtori për mjedisin"	03/2019	MTHM	5000	Donatorët	OJQ "ERA"	Dekanati	Pjesëmarrës: 80 studentë 10 Profesorë	E realizuar
Aktivitete për ditën botërore të tokës	04/2019	MTHM, FAG	500	Donatorët	MMPH, Instituti I pylltarisë në Pejë	MTHM, FAG	Pjesëmarrës: 100 studentë, 10 staf akademik, 20 përfaqësues nga ministria, 10 staf administrativ	E realizuar
Ligjëratë për ditën botërore për turizëm	09/2019	MTHM	300	UHZ	UHZ	MTHM	100 pjesëmarrës (student, staf akademik etj.)	E realizuar (100 pjesëmarrës)
Ligjëratë nga Profesori - Universiteti ushtarak Sofje Tema: Transicioni për tu inkuadruar në BE - Eksperienca bullgare	02/2019	MTHM	300	150 euro donatorët dhe 150 UHZ	Universiteti Sofje dhe UHZ	Dekanati	Rreth 100 pjesëmarrës 70 studentë, 15 staf akademik, 15 staf administrativ	Po
Aktivitete rreth ditës së vjeljes së boronicës së butë	06/2019	FAG	500	Donatorët	USAIDI, Kuvendi komunal, MBPZHR	FAG	Rreth 40 pjesëmarrës 35 studentë, 5 staf akademik,	Po
Ligjëratë në fushën e sigurimeve: "Njoftim mbi	04/2019	FB	100	50 EURO UHZ DHE 50 Shoqata e	Shoqata e sigurimeve	FB	Pjesëmarrja: 50 studentë	E realizuar (Referues: Drejtori i Shoqatës;

	industrinë e sigurimeve"				sigurimeve të Kosovës				pjesëmarrës rreth 70)
	Ligjërata "Themelimi i Institutit për Inovacioni dhe Ndërmarrësi "	03/2019	FB	250	UNHZ	Ministria e Inovacionit	FB	200 Pjesëmarrës student 15 staf akademik	Po
	2 ligjërata nga fusha e tatimeve dhe kontabilitetit "Sistemi Tatimor në Kosovë dhe zhvillimi ekonomik" "Institucione t mikrofinanciare dhe mikrofinancat"	10/2019	FB	100	UNHZ	Përfaqësues te ATK dhe MF	Dekanati	2 ligjërata e mbajtura	E realizuar (Referues; Përfaqësuesi i BQK; pjesëmarrës rreth 65)
Projekti për trajnim për mësimdhënie online (e-learning)	Projekti i hartuar për Kompletimin e sallës Implementimi i trajnimit	09/2019	Rektorati	7500	UNHZ/Donatorët	Pro-Rektorja për mësimdhënie	Rektorati	Katër mësimdhënës nga secila njësi akademike të trajnuar (gjithsejtë 20)	Projekti është hartuar dhe një projekt nga ERASMUS+ është duke u realizuar për Fakultetin Juridik; Klinikat ligjore në shërbim të grupeve të cënueshme: rritja e punësimit të studentëve të drejtësisë përmes arsimit praktik 2019-2022.
Projekti për aplikim të metodologjive moderne për hulumtime shkencore	Krijimi i projektit për trajnime rreth hulumtimeve shkencore Implementimi i projektit	07/2019 09/2019	UNHZ	3500	UNHZ/Donatorët	Pro-rektorja për mësim	Rektorati	Katër mësimdhënës nga secila njësi akademike të trajnuar	Është duke u realizuar nga muaji Tetor 2019 ka filluar se zbatuari Projekti Erasmus+ Përmirësimi i kulturës së kërkimit në

								(gjithej 20)	arsimin e lartë në Kosovë (Research-Cult) 2019-2022 http://unhz.eu/en/hancing-research-culture-in-higher-education-in-kosovo-t/
Hapja programit të artit figurativ	Hartimi i programit Hapja e konkursit Mbrojtja e programit	10 /2019	FA /AKA	3300	UNHZ/AKA	Koordinatori i programit	Dekanati/Rektorati	Programi që është planifikuar për vitin 2018 do të realizohet në vitin 2019	Jo (është shtyrë për shkak të hapësirës fizike)
Projekti përhapjen e programit master në shkencat ushqimit	Hartimi i programit Hapja e konkursit Mbrojtja e programit	10/2019	FAB /AKA	3300	UNHZ/AKA	Koordinatorët e programit	Dekanati/Rektorati	Ky aktivitet ishte paraparë në vitin 2018 dhe do të realizohet në vitin 2019	Në proces
Projekti për hapjen e programit master në prodhim bimor	Hartimi i programit Hapja e konkursit Mbrojtja e programit	10/2019	FAB /AKA	3300	UNHZ/AKA	Koordinatorët e programit	Dekanati/Rektorati	Ky aktivitet është propozim i ri	Jo (Është shtyrë për vitin e ardhshëm akademik)
Projekti për rridizajnimin e programeve ekzistuese në nivelin bachelor	Përgatitja e raportit të vetëvlerësimit për ri-akreditimin e programeve ekzistuese: Ri-akreditimi i programit EAI (FA) Ri-akreditimi i 3 programeve - AA; TPB; TU (FAB) 3 programe bachelor 3 master (FB) 1 program bachelor 1 programe master (FJ) Bashkëpunimi me	01/2019	Fakultetet përkatëse	300	UNHZ/AKA	FA FAB FJ FMTH FB	Prorektori për Cilësi/Dekanatët	Programe të studimeve Bachelor janë rishikuar dhe rridizajnuar nga të gjitha fakultete	E realizuar Programet janë në proces të akreditimit

	Agjencinë e Akreditimit dhe me Auditorët e jashtëm gjatë procesit të auditimit								
Projekti për dizajnimin e programeve të reja në nivelin bachelor, master dhe doktoratë	Përgatitja e raportit të vetëvlerësimit për akreditimin e programeve të reja: Një program të ri në MTHM: (MTHM) Një program të ri: EM (FA) Akreditimi i I programi të doktoratës (FB) I programi ri master (FJ) Bashkëpunimi me Agjencinë e Akreditimit dhe me Auditorët e jashtëm gjatë procesit të auditimit	01/2019	Fakultetet përkatëse	300	UNHZ/AKA	FA FAB FJ FMTH FB	Prorektori për Cilësi/Dekani	Programe të studimeve Bachelor janë rishikuar dhe ridizajnuar nga të gjitha fakultete	Po Programet janë në proces të akreditimit
Dizajnimi i programit të ri mësimor në nivelin master (FA)	Programi Master: EMM (FA)	Në proces të akreditimit 01/2019	Fakultetet përkatëse	3300	UNHZ/AKA	FA	Prorektori për Cilësi/Dekani		E realizuar
Dizajnimi i programit të ri mësimor në nivelin master (MTHM)	Programi master: MTM (MTHM)	Në proces të akreditimit 01/2019	MTHM	3300	Në proces të akreditimit	MTHM	Prorektori për Cilësi/Dekani		Në proces
Dizajnimi i programit të ri mësimor në nivelin	Programi master: MTQ (menaxhim i qëndrueshëm në	10/2019	MTHM	3300	UNHZ/AKA	MTHM	Prorektori për Cilësi/Dekani		Në proces

master (MTHM)	turizëm) (MTHM)								
Programi përbashkët me Universitetin e Gjilanit dhe atë të Prizrenit	Vazhdimi i programit	2019	UNHZ/UPZ/UGJ	Shpenzi met nga kodi i pagave	UNHZ/AKA	UNHZ/PZ/GJ	UNHZ/PZ/GJ	Viti i parë i përfunduar dhe fillimi në 10.2018 i vitit të dytë akademik	E realizuar
Klinika juridike penale-vazhdimësi	Vazhdon	05/2019	FJ	400	UNHZ/USAID	Koordinatori i klinikës/ Ligjëruesit	Dekanati	Realizimi rregullt i klinikave të tilla Pjesëmarrja në garë me universitetet e tjera publike të Kosovës	E realizuar
Organizimi i ceremonisë dhe ndarja e çmimeve për profesorët dhe studentët e dalluar	Avancimi i kritereve Shpallja Themelimi i komisioneve Përpilimi i listës së ngushtë Shpallja e fituesve	10/2019 11/2019 12/2019	UNHZ/FA/FAB/FJ/MTHM/FB	1300	UNHZ/Donatorët	Dekanatët	Rektori	Më shumë marrin çmimet	E realizuar (shih protokollin)
Hapja e programit profesional të gastronomisë	Hartimi i programit Aplikimi në AKA	06/2019	MTHM	1500	UNHZ/AKA	Koordinatori i programit	Dekanati	Programi në AKA	Jo (shtyhet për vitin ardhshëm)
Pjesëmarrja në garë ndërkombëtare për gjykim të simuluar ndërkombëtar (FJ)		11/2019	FJ	4000	FJ			2-3 studentë dhe 2 staf marrin pjesë në garë	Është realizuar. Studentët kanë marrë pjesë në garën "European International Humanitarian and Refugee Law Moot Court Competition"
Projekti i tutorimit për ngritje të kalueshmërisë në lëndët e caktuara (mësimdhënës-student)	Vazhdon edhe për vitin 2019 Identifikimi i lendeve Përcaktimi i tutorëve Fillimi i tutorimit	05/2019	Fakultetet	2000	UHZ/Donatorët	Rektorati	Rektorati	Projekti i tutorimit kryhet në të gjitha njësitet akademike. Kalueshmëria rritet për 20%	E realizuar

dhe student student)									
Panairi për ndërmarrësi (FB)	Hartimi i projektit Identifikimi i donatorëve Mbatja e panairit	11/2019	FB	2000	UHZ/Donatorët	FB		Pjesëmarrës rreth 300 studentë	Jo (Aktiviteti ishte planifikuar të organizohej me financimin e donatorëve që nuk patëm mundësi t'i gjejmë))
Totali i shpenzimeve për objektivin e parë:				62350	UHZ=62150 Eu Donatorët= 200 Eu				

OBJEKTIVI STRATEGJIK 2

Avancimi i hulumtimeve dhe orientimi drejt inovacionit

Nën-objektiva t:	<ul style="list-style-type: none"> • Ngritja e reputacionit dhe përmirësimi në nivel ndërkombëtar; • Revistë e profilit përkatës në çdo njësi akademike; • Themelimi i instituteve hulumtuese; • Organizimi i konferencave ndërkombëtare multi-diciplinare; • Përkrahja e stafit akademik për pjesëmarrje në konferenca, botime dhe në projekte të përbashkëta hulumtuese dhe artistike në nivel ndërkombëtar; • Përfshirja studentëve në projekte hulumtuese. 								
PROJEKTET / AKTIVITETET	Aktivitetet/Hapat	Koha/muaji	Palet Përgjegjëse	Kostoja (Euro)	Financuesit	Bartësit	Mbikëqyrës	Indikatorët matës	Vërejtje
Pjesëmarrje në projektin e zhvillimit regional rural	Vazhdimi komunikimit ndër-regjional Pjesëmarrja në takimet e përbashkëta	03.2019	UNHZ/KKT/KKS H/ MBZHR	200	KE	Dekanati	Komiteti drejtues i projektit/KE	Takimi në Shkodër	E realizuar
Organizimi i akademisë studentore të historisë muzikore	Përgatitja e planit për akademi Ftesat Organizimi	11/2019	FA/FAT	650	UNHZ – 150 EURO dhe donatorët 500 euro	Koordinatorët e akademisë 10 studentë prezantues	Dekani	Pritet pjesëmarrje e së paku 50 studentëve	Jo (Ligjëruesi prof. Nestor Kraja nga Shqipëria nuk ka arritur të jete prezent për shkaqe shëndetësore shih. E-mailat te Dekani i Arteve)
Projekti për fillimin e botimit të revistës multi-disiplinare shkencore	Krijimi komisionit për themelimin e revistës	09/2019	Rektorati	200	UNHZ/	Pro-rektorja për mësim dhe Komisioni	Rektori	Draft dokumenti për revistën në themelimin	Jo (Nuk është gjetur konsensusi nëse revista duhet të jetë në nivel të institucionit apo në nivelin e njëjësive akademike)

Projekti i konferencës vjetore në fushat juridike dhe arteve	Identifikimi i fushave specifike Krijimi i Komitetit Organizativ Shpallja e thirrjes Ftesat dhe organizimi	02.2019 02.2019 03.2019 11.2019	FJ/FA	5000	UNHZ/ Donatorët/ Autorët	Komiteti organizativ	Dekanati	Organizimi i konferencës 100 pjesëmarrës 20 folës	Jo (Është shtyrë për vitin 2020)
Projekti për hapjen e Instituteve të Hulumtimeve, në fushat e biznesit dhe turizmit dhe shkencave Juridike	Vazhdimi me aktivitetet rreth themelimit dhe funksionalizimit të instituteve	06.2019 10.2019	FB/MTMH/FJ	1000	UNHZ /Donatorët	Komisionet për përgatitjen dhe funksionalizimin e Institutit	Dekanatet FB/MTMH/FJ	Fillimi i punës së paku njërit nga institutet gjatë vitit 2019	Themelimi i instituteve është në fazën fillestare (krijimi i infrastrukturës ligjore për themelimin e tyre) dhe është arritur progres rreth themelimit të Qendrës për Inovacion dhe Ndërmarrësi si dhe rreth themelimit të Institutit "Theory to practice)
Organizimi i Konferencës Ndërkombëtare në fushën e ekonomisë dhe të biznesit	Vazhdimi - mbajtja e konferencës edhe gjatë vitit 2019 Përcaktimi temave Shpallja e ftesës për pjesëmarrje Organizimi i Konferencës	03.2019 04.2019 09.2019	FB/MTMH/FAB/	6500	UNHZ/Autorët	Komiteti Organizativ	Dekanati	Konferenca mbahet me sukses 2019. Pjesëmarrja e së paku 4 ose 5 shkencëtarëve ndërkombëtar dhe 100 pjesëmarrës të tjerë	Jo
Projekti për themelimin dhe Funksionalizimin e Institutit Hulumtues në Agrobiznes	Vazhdohet me aktivitetet rreth themelimit të Institutit (përmes projektit RASMUS+) Themeli i Komisionit për funksionalizimin Përpilimi i Rregullores	11/2019	FAB	2000	UNHZ /Donatorët	Komisionet për përgatitjen dhe funksionalizimin e Institutit	Dekanati	Përpilimi i rregullores për themelimin e Institutit.	Jo Ne zhvillim Krijimi i rregullores për Institut është shtyrë për shkak të projektit funksional të përbashkët me Mitrovicën dhe partnerët e tjerë

	për Institute ne njësi Themelimi organeve udhëheqëse								
Implementimi i projekteve për studime në sundimin e ligjit dhe drejtave të njeriut	<p>Inicimi i projekteve të përbashkëta me studentë</p> <p>Identifikimi i projekteve Implementimi i projekteve</p>	<p>04/2019</p> <p>05/2019</p> <p>12/2019</p>	FJ	3000	UHZ=1500 /Donatorët=1500	Dekanati		Publikimi i një punimi shkencor 2020	<p>Është fituar projekti " "Kurse të shkurtra mbi dhunën ndaj grave: Të drejtat e njeriut, politikat dhe teknikat e kërkimit" që do të realizohet se nga sti dhe studentët e UHZ dhe studentët & stafi akademik i Sapienza University of Rome. Ky projekt do të përfundoj në prill 2021.</p> <p>(http://unhz.eu/s hort-courses-on-violence-against-women-human-rights-policies-and-research-techniques/)</p>
Konkursi i përzgjedhjes së punimeve të botuara në revistat e indeksuara shkencore dhe ndarja e shpërblimeve	<p>Vazhdon edhe në vitin 2019</p> <p>Njoftimi për Konkursin për punime shkencore</p> <p>Krijimi Komisionit vlerësues ne nivel UHZ</p>	<p>11.2019</p> <p>12.2019</p>	UHZ	600	<p>Vendi i parë 300 euro</p> <p>Vendi i dytë 200 euro</p> <p>Vendi i tretë 100 euro</p> <p>UHZ/ Donatorët</p>	Komisioni/ Rektori themelon Komisionin	Rektori	Punimeve me të mira janë përzgjedhur	Është në proces (pritet që përzgjedhja të kryhet më së largu deri me 15 janar)
Projekte hulumtuese ose artistike në kuadër të Universitetit	<p>Shpallja e konkursit të brendshëm për projekte hulumtuese</p> <p>Krijimi i komisionit vlerësues</p> <p>Përzgjedhja e 2 projekteve më të mira në kuadër të universitetit</p> <p>Paradhënia e 40% e shumës së përgjithshme</p>	<p>05/2019</p> <p>06/19</p> <p>12/2019</p> <p>12/2020</p>	UHZ/Donatorët	2400	UHZ/Donatorët	Rektorati	Rektori	Një punim i publikuar në platformën e Eb of Science ose Scopus më së largu deri në fund të vitit 2020	Edhe pse KD ka marrë vendim për përkrahje, procedurat për implementimin e projekteve akoma nuk kanë filluar

	<p>për realizimin e projektit Publikimi i rezultateve të hulumtimit në revistat e indeksuara në platformat Eeb of science ose Scopus më së largu deri në fund të vitit 2020</p> <p>Pjesa e dytë e pagesës (60%) pas publikimit</p>								
<p>Pjesëmarrja e personelit akademik në konferenca ndërkombëtare</p>	<p>I gjithë personeli akademik ka të drejtë të kërkojë mbulesën e një pjese të shpenzimeve (50% nga shpenzimet e përgjithshme dhe jo më shumë se 500 Euro) për pjesëmarrje në një konferencë ndërkombëtare gjatë vitit 2019.</p> <p>Kushtet e mbulimit të shpenzimeve janë: Prezantimi në konferencë si folës ose me poster Autor I parë ose korrespondent Kërkesa duhet t'i parashtrohet KO me letër ftesë.</p>	<p>01/2019</p> <p>1</p> <p>2/2019</p>	<p>UHZ/Donatorët</p>	<p>20000</p>	<p>UHZ/Donatorët</p>	<p>Rektorati</p>	<p>Rektori</p>	<p>Pjesëmarrja e 50 anëtarëve nga stafi akademik në konferenca ndërkombëtare</p>	<p>Po - disa (Vendimet e Këshillit Drejtues dhe Departamenti i Financave i ka të dhënat)</p>

	abstrakt të pranuar dhe me specifikim të detajuar të shpenzimeve								
Trajnimi i personeli për avancim në mësimdhënie dhe në hulumtim	Identifikimi i temave të trajnimit Aranzhimi i sjelljes së ekspertëve sipas fushave të identifikuar Mbajtja e trajnimeve	06/2019 09/2019 11/2019	UHZ/Donatorët	3000	UHZ/Donatorët	Rektorati	Rektori:	50 anëtarëve nga stafi akademik të trajnuar për fusha të ndryshme	Është hartuar Plani për Zhvillim Akademik të Stafit dhe Plani i Veprimit për Zbatimin e Strategjisë për Kërkime Shkencore. Trajnimi i stafi akademik për hulumtime do të realizohen edhe nga projektet e lartçekur të ERASMUS+ për vitet 2019-2022.
Organizimi i kursit 6 mujor të gjuhës angleze për studentët (70 studentë) e UHZ-së	Identifikimi i nivelit të trajnimit (themelor, i avancuar, etj.) Identifikimi i ndërmarrjes së specializuar për mbajtjen e kurseve të gjuhës angleze dhe përfundimi i procedurave për përzgjedhje të kompanisë Përzgjedhja e studentëve Mbajtja e kurseve	05/19 06/19 10/19 11/19	UHZ/Donatorët, Organizata studentore	5000	UHZ/Donatorët	Rektorati/Organizata studentore		70 studentë kalojnë me sukses testin pas përfundimit të kursit	Pjesërisht (Në FB janë përgjatë dy semestrave janë mbajtur kurse të gjuhës angleze për studentët përmes programit Full Bright (të dhënat i sjellë dekani i FB)
Organizimi i kursit 6 mujor të gjuhës angleze për staf akademik (25 staf akademik) e UHZ-së	Identifikimi i nivelit të trajnimit (themelor, i avancuar, etj.) Identifikimi i ndërmarrjes së specializuar	06/19 07/19	UHZ/Donatorët	5000	UHZ/Donatorët	Rektorati	Rektorati	25 staf akademik përfundojnë në kursin e gjuhës angleze	Jo (Ky aktivitet është shtyrë për vitin e ardhshëm. Përndryshe gjatë vitit 2019 janë organizuar kurse të gjuhës angleze për përfaqësuesit e administratës së universitetit (të

për mbajtjen e kurseve të gjuhës angleze dhe përfundimi i procedurave për përzgjedhje të kompanisë	10/19 11/19								dhënat nga administrata)
Përzgjedhja e stafit akademik									
Mbajtja e kurseve									
Totali i kostove të objektivit të dytë				5455 0	UHZ=52550 Eu Donat.=200 0 Eu				

--	--	--	--	--	--	--	--	--	--

OBJEKTIVI STRATEGJIK 3
Bashkëpunimi ndërkombëtar dhe ndërinstucional

Nën-objektivat	<ul style="list-style-type: none"> • Avancimi i bashkëpunimit me projekte të përbashkëta; • Organizimi i programeve të përbashkëta; • Rritja e mobilitetit të stafit dhe të studentëve; • Organizimi i konferencave dhe aktiviteteve të përbashkëta me partnerë relevantë; • Krijimi i mundësive të reja për studentët tanë (intenship, vazhdim studimesh etj.); • Rritja e vazhdueshme e përfitimeve në aspektin akademik dhe financiar.
-----------------------	---

PROJEKTET / AKTIVITETET	Aktivitetet/Hapat	Koha/ muaji	Palët përgjegjëse	Kostoja (Euro)	Financuesit	Bartësit	Mbikëqyrës	Indikatorët matës	Vërejtje
Mbajtja e koncertit semestral		01/2019	FA	80	UHZ	Dekanati	Dekanati	15 studentë kanë interpretuar	
Projekti për rritjen e Fakultetit të Agrobiznesit	Aktivitetet rreth përgatitjes së RVV dhe mbrojtja para ekspertëve ndërkombëtar të programit të përbashkët me UP në fushën e Bujqësisë Urbane	01/2019 03/2019 10/2019	FAB/ Partnerët	94500	Erasmus +/ Donatorët/UP P/UHZ UHZ 700 euro/UP 3800/Erasmus 90000	Dekani	Rektorati	Fakulteti i Agrobiznesit ka përfunduar me sukses aktivitetet në kuadër të projektit ndërkombëtar BUGI Përpos vizitave në Itali, Gjermani,	E realizuar

	Aktivitetet rreth përgatitjes dhe zbatimit të procedurave tenderuese për një serrë pranë FAB Fillimi i programit master në BU							Sllloveni dhe BeH., ekspertët e angazhuar në projekt kanë përfunduar të gjitha obligimet për mbarëvajtjen e projektit	
Projekti i përbashkët i Fakultetit të Agrobiznesit dhe Universitetit të tjera MSc in Sustainable Food Production Systems / STEPS	Takimi i parë Punëtorja në Rumani	03/2019 06/2019	FAB/ Partnerët		Erasmus +/ Donatorët/	Dekani	Rektorati		E realizuar
Projekte për shfaqjen e vlerave muzikore të UHZ	Përgatitja e planit për mbajtjen e Koncertit në Gjermani Identifikimi i pjesëmarrësve Realizimi	02/19 04/2019 06/2019	FA	10000	UHZ 2400/ Donatorët 7600	Dekanati	Rektorati	Pjesëmarrja në koncert - 21 studentë; 7 profesorë	E realizuar
	Mbajtja e koncertit semestral	01/2019	FA	150	UHZ	Dekanati	Rektorati	Pjesëmarrja rreth 70	E realizuar
	Pjesëmarrja në festivalin ndërkombëtar të Evropës Juglindore								E realizuar
	Koncerti Semestral	01/2019	FA	200 euro	UHZ	Dekanati	Rektorati	Pjesëmarrja rreth 100	E realizuar
	Koncert neper qytetet Kosovës klasa e e Prof.Asoc. Fatbardh Gashi	03/19	FA	0 euro	UHZ	Dekanati	Rektorati	Pjesëmarrja rreth 70	E realizuar

	Festivali Dam	03/19	FA	0 euro	UHZ	Dekanati	Rektorati	Pjesëmarrja rreth 300	E realizuar
	Garat Pjeter Gaci Shkodër	04/19	FA	0 euro	UHZ	Dekanati	Rektorati	Pjesëmarrja rreth 80	E realizuar
	Koncerti Pjesa e pare e koncertit ne Tirane Entela Demi	04/19	FA	0 euro	UHZ	Dekanati	Rektorati	Pjesëmarrja rreth 200	E realizuar
	Kori I Fakultetit te Arteve / Glllogjan	04/19	FA	0 euro	UHZ	Dekanati	Rektorati	Pjesëmarrja rreth 1000	E realizuar
	Koncerti I Fakultetit te Arteve ne Teatër Istref Begolli	04/19	FA	0 euro	UHZ	Dekanati	Rektorati	Pjesëmarrja rreth 150	E realizuar
	Komcert ne Tirane	05/19	FA	0 euro	UHZ	Dekanati	Rektorati	Pjesëmarrja rreth 300	E realizuar
	Java Artistike studentore	06/19	FA	1500euro	UHZ	Dekanati	Rektorati	Pjesëmarrja rreth 500	E realizuar
	Koncert ne Festivalin TEHD - Tetove	06/19	FA	500 euro	UHZ	Dekanati	Rektorati	Pjesëmarrja rreth 350	E realizuar
	Koncert ne Greqi	09/19	FA	2000euro	UHZ	Dekanati	Rektorati	Pjesëmarrja rreth 800	E realizuar (Në vend se në Greqi koncerti është mbajtur në Maqedoninë e veriut)
	Koncert ne Peje përvjetorin e UHZ	11/19	FA	300 euro	UHZ	Dekanati	Rektorati	Pjesëmarrja rreth 300	E realizuar
	Koncerti Semestral	12/19	FA	700 euro	UHZ	Dekanati	Rektorati	Pjesëmarrja rreth 130	E realizuar
Trajnimi stafit për aplikim në projekte dhe grande ndërkombëtare	Identifikimi i fushave për trajnim Identifikimi i pjesëmarrësve Organizimi i trajnimit	07/2019 09/2019 11/2019	UHZ/ Partnerët	2000	UHZ/ Donatorët	Komisioni përkatës i themeluar nga Rektori	Rektorati	Së paku dy përfaqësues të UHZ trajnohen dhe bëhen trajner për të trajnuar stafin e universitetit për aplikim në projekte ndërkombëtare	Është realizuar (me përkrahje të Projektit HERAS)

Këshillim dhe trajnimi i studentëve për aplikim në fonde ndërkombëtare	Ngritja e Grupit për mbështetje studentëve për aplikim Përgatitja e agjendës për këshillim dhe trajnime të studenteve Organizimi i trajnimeve këshillimeve dhe ditëve informuese	06/2019 09/2019 11/2019	UHZ/Studentët/ Partnerët	600	UHZ/ Donatorët	Grupi përkatës/ Trajnuesit dhe këshilluesit	Rektorati	Këshillim dhe trajnimi i 20 studentëve në vitin 2019	Studentët kanë qenë të ftuar për të marr pjesë në sesione informues për aplikim në fonde të organizuar nga ERASMUS+, etj. Qendra Për Zhvillim të Karrierës ka ofruar këshilla vazhdimisht për këtë qëllim për studentët e interesuar.
Aktivitetet të ndërlidhura me bashkëpunimin dhe zhvillimin e UHZ	Vazhdimi i rrjetëzimit të UHZ Anëtarësimi në asocionet universitare	03/2019 09/2019	UHZ	1000	UHZ/ Donatorët	Prorektori për bashkëpunim Dekanatet	Rektori/KO	Anëtarësimi në shtetë paku 2 asocionet	Nuk ka konfirmim për anëtarësimin e UHZ-së
Marrëveshjet me universitetet e tjera	Marrëveshjet me universitetet evropiane Marrëveshjet me universitetet regionale	01/2019 06/2019	UHZ	1000	UHZ	Prorektori për bashkëpunim		Së paku 2 marrëveshjet bashkëpunimi	Gjatë vitit 2019, UHZ ka nënshkruar 5 marrëveshjet bashkëpunimi me Universitetet e tjera evropiane
Totali i kostove të objektivit se trete				121200	UHZ=16800 Eu Donat.=104400 Eu				

OBJEKTIVI STRATEGJIK 4
Menaxhimi dhe zhvillimi i qëndrueshëm i burimeve

Nën-objektivat	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Burimet njerëzore: ▪ Riorganizimi dhe organogrami i ri; ▪ Përmirësimi i vazhdueshëm i shërbimeve për stafin dhe studentët; ▪ Ngritja e kapaciteteve dhe trajnimi i vazhdueshëm i stafit administrativ; ▪ Transparenca dhe llogaridhënia e vazhdueshme. ▪ Burimet financiare: ▪ Shndërrimi në njësi të pavarur buxhetore; ▪ Planifikimi dhe rritja e qëndrueshme buxhetore; ▪ Krijimi i burimeve alternative buxhetore; ▪ Llogaridhënia dhe transparenca e shfrytëzimit të parasë dhe e pronës së UNHZ-së. ▪ Burimet infrastrukturore dhe burimet e TI-së ▪ Zgjerimi i infrastrukturës fizike-hapësinore (FB, FA dhe i objekteve tjera ▪ Ndërtimi i objektit të konvikteve dhe i mensës së studentëve; ▪ Ndërtimi i sallës digjitale për qëllime të shumfishta; ▪ Krijimi i studios muzikore me pajisje përcjellëse ▪ Ndërtimi i objekteve sportive universitare; ▪ Zgjerimi i laboratorëve dhe ngritja e kapaciteteve vetjake; ▪ Digjitalizimi i shërbimeve, i administratës dhe i punës akademike; ▪ Ngritja e numrit të pajisjeve elektronike në dispozicion të studentëve dhe të stafit; ▪ Digjitalizimi i bibliotekës universitare; ▪ Qasje në data-bazën shkencore ndërkombëtare 								
PROJEKTET / AKTIVITETET	Aktivitetet/Hapat	Koha/muaji	Palët përgjegjëse	Kostoja (Euro)	Financuesit	Bartësit	Mbikëqyrës	Indikatorët Matës	Vërejtje
Projekti për zhvillimin e ekonomisë lokale, i fokusuar në prodhimet vendore dhe në agroturizëm	Vazhdimësi Pjesëmarrje në procesin e vjeljes	07/2019	FAB/ Total Barry Service-USAID	500	UNHZ=0 Euro Donatorët=500 Eu	Dekanati	Rektori/ USAID	20 studentë pjesëmarrës	E realizuar
Përditësimi i strategjisë për sigurimin e cilësisë	Puna e komisionit për përditësimin e strategjisë së cilësisë	10/2019	UNHZ	1000	UNHZ	Prorektori për cilësi/ Administrata	Rektori	Strategjia e përditësuar	Në proces
Krijimi i bazës së të dhënave (data-bazës) për mbledhje të informatave dhe të dhënave	Funksionalizimi i data-bazës	12/2019	UNHZ	500	UNHZ	GP	Prorektori për cilësi dhe Prorektori për mësim, Sekretari UNHZ	Data-baza e funksionalizuar deri në fund të vitit 2019	E realizuar (SEMS funksional me të gjitha të dhënat për personelin akademik, programet studimore etj)
Projekti i hartimit të Planit për zhvillim të vazhdueshëm të personelit	Aprovimi i planit Implementimi								Është hartuar dhe miratuar plani nga Senati. Grupi është duke hartuar planin e veprimit për 2020.

